



REPUBLIKA E MAQEDONIS SË VERIUT  
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_г./в.



Komisioni shtetëror për parandalimin e korrupsionit, në bazë të nenit 22 dhe 23 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" Nr. 12/2019) dhe në përputhje me nenin 40 fq 2 dhe 41 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit dhe nenit 4, nga udhëzimi për renditjen e lëndëve për veprim të KSHPK-së në bazë të denoncimeve të dorëzuara, duke vepruar sipas lëndës së formuar sipas denoncimit të pranuar nga parashtuesi i njohur në vazhdimin e parë të seancës së 51-të, të mbajtur më 01.09.2021, morri vendimin vijues:

#### VENDIM

Denoncimi i /// /// /// nga /// dorëzuar në Komisionin Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit në bazë të të cilit është formuar lënda me numër 12-1542/1të datës 12.04.2021, REFUZOHET.

Në përputhje me dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" Nr. 12/19), Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit konstaton se organ tjetër është kompetent të vepron në denoncimin e theksuar më sipër.

Lënda me numër 12 -1542 e vitit 2021 të mbyllet dhe të arkivohet.

Deri te parashtuesi i denoncimit të dorëzohet Vendimi i Komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit, me arsyetim.

Vendimi i Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, me arsyetim- në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e internetit të saj në afat prej 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

#### Arsyetim

Lënda me numër 12-1542/1i datës 12-1542/1 në Komisionin Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (në tekstin e mëtejme: KSHPK) e formuar në bazë të një denoncimi të marrë nga /// /// /// nga /// (në në tekstin e mëtejme: parashtuesi).

Në denoncim pohoet për korrupsion nga personi zyrtar - gjyqtar në/// /// /// /// ///, personit /// /// i cili, sipas pohimeve në denoncim, ka kryer abuzim me pozitën zyrtare që ka vepruar sipas lëndës të regjistruar në gjykatë me numrin /// /// pa e marrë të njëjtën në punë përmes sistemit elektronik të menaxhimit të çështjeve gjyqësore. Jepen të dhëna se lënda gjyqësore është marrë me dorë, si dhe se personi zyrtar i treguar ka vepruar në një çështje tjetër gjyqësore të veçantë në të njëjtën gjykatë të regjistruar me numrin ///, ku të njëjtët persona u paraqitën si kërkues, dhe i akuzuar ishte i njëjti person. Shprehet paknaqësi nga mënyra e tillë e punës, për të cilën parashtruesi konkludon se personi zyrtar i treguar në denoncim veproi kështu "për shumë të madhe parash". Nga KSHPK kërkohet ta rishqyrtojë këtë rast në përputhje me kompetencat e saj ligjore. Në ddenocimin u dorëzuan prova.

Pas studimit të pohimeve në denoncim, KSHPK konstatoi se në rastin konkret, parashtruesi shpreh pakënaqësi në mënyrën e organizimit dhe punës së gjykatës së mësipërme për rastet gjyqësore të treguara. Në përputhje me nenin. 17 paragraf. 1 a 1 të Ligjit për organizimin dhe punën e organeve të administratës shtetërore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë Veriore" Nr. 58/00 ... 51/11): "Ministria e Drejtësisë kryen aktivitetet që lidhen me: gjyqësorin, zyrën e prokurorit publik, ombudsmanin publik.", kështu që nëse parashtruesi konsideron se organizimi dhe puna e gjykatës për rastet e treguara gjyqësore nuk është në përputhje me ligjet, ai mund t'i drejtohet Ministrisë së Drejtësisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut, për veprime kompetente. Prandaj, KSHPK konstaton se kompetent për të vepruar sipas pohimeve në denoncim nga parashtruesi është organ tjetër në përputhje me dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 12/19), KSHPK nuk ka kompetencë ligjore për të vepruar sipas lëndës, denoncimi i parashtruesit të refuzohet dhe lënda të mbyllet dhe të arkivohet. Duke pasur parasysh të theksuarën më sipër, KSHPK vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Dorëzuar deri te:

- Arkivi i KSHPK -së
- Parashtruesi
- Përgaditi: Mr D. D.
- Miratuar: Mr.Sh. S.

KOMISIONI SHTETËROR  
PËR PARANDALIMIN E KORRUPTIONIT  
Kryetar,  
Biljana Ivanovska

